



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 11 dhe 17 shkronja r, të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenin 19 paragrafët 3 dhe 4 të Ligjit nr.04/L-106 për Teatrot, nenit 10.1 shkronja c të Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje të mjeteve buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.01/111-400 të datës 28 maj 2012, nenin 1 pika 3 të Rregullores për ndryshimin e Rregullores për caktimin e kriterëve për ndarje buxhetore nga kategoria ekonomike subvencione dhe transfere nr.1/172-400 të datës 27 shtator 2012, neneve 14 dhe 19 shkronja r, të Statutit të Komunës së Podujevës nr.01-1/298-10, dhe nenit 17 të Statutit të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani" nr.01-640-93374 dt.28.12.2016, sipas kërkesës së Teatrit të qytetit "Avdush Hasani", të proceduar nga Drejtoria e Kulturës Rinisë dhe Sportit nr.01-640/01-0044706/17, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 30 qershor 2017, miratoi,

VENDIM

PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TEATRIN PUBLIK TË QYTETIT "AVDUSH HASANI" NË PODUJEVË

Neni 1

Teatri i Qytetit "Avdush Hasani" në Podujevë, për funksionimin dhe zhvillimin e aktiviteteve programore dhe mbulimin e shpenzimeve operative të veprimtarisë teatrale sipas objektivave strategjike përkatësisht realizimin e repertorit – projekti i parë, për vitin 2017, mbështetet me mjete financiare në shumë 9.900,00 €.

Neni 2

Mjetet financiare sipas nenit 1 të këtij Vendimi ndahen nga kategoria e subvencioneve dhe transfereve të Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit.

Shuma e mjeteve bartet në konton bankare të Teatrit të Qytetit "Avdush Hasani".

Neni 3

Zbatimi i Vendimit bëhet nga Drejtoria e Buxhetit dhe Financave.

Neni 4

Vendimi hyn në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-401/01-0047716/17
Podujevë,
30 qershor 2017



Kryesuesi i Kuvendi
Mehmet Gashi